



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 27.03.2025
Numër Protokolli: 2613/2025

A.nr.234/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.130/.2025 të datës 17.01.2025 të parashtruar nga ankuesi N.D. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “SCLR Partneres” me seli në Prishtinë dhe ankesën me numër A.nr.234/2025 të datës 29.01.2025 të parashtruar nga ankuesi E.H. të cilat në bazë të Vendimit të datës 12.03.2025 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, janë bashkuar në ankesën me numër A.nr.234/2025 kundër Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ e filluar sipas ankesës me numër A.nr.130/2025, e datës 17.01.2025, e parashtruar nga ankuesi, N.D. dhe ankesa me numër A.nr. 234/2025 e datës 29.01.2025 e parashtruar nga ankuesi E.H.

A r s y e t i m

Ankuesit, N.D. dhe E.H. (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesit), kandidatë për pranim sipas procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015652, të shpallur më datë 30.10.2024 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, për pesë (5) pozitat e punës “Inspektor Fitosanitar”, më datë 17.01.2025 dhe 29.01.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 342/2025 dhe 610/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër zhvillimit të kësaj procedure të rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbështetje të dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueseve tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa kjo e fundit, më datë 03.02.2025 dhe 21.02.2025, kanë përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës me numër A.nr.130/2025 të datës 17.01.2025, të parashtruar nga ankuesi N.D. dhe ankesës me numër A.nr.234/2025 të datës 29.01.2025, të parashtruar nga ankuesi E.H, pasi që kanë vlerësuar që pretendimet e ankuesve janë të ndërlidhura me procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015652, për pozitën e punës “*Inspektor Fitoasnitari*” në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të shpallur me datën 30.10.2024 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, përkatësisht meqenëse të gjitha ankesat kanë objektin e njëjtë dhe faktet dhe baza ligjore për vendosje janë të njëjta atëherë sipas Vendimit të datës 12.03.2025 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të dy këto ankesa janë bashkuar në ankesën e fundit me numër A.nr.234/2025.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1701/2025 të datës 13.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueseve, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 30.10.2024 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit me numër reference RN00015652, gjegjësisht për pesë (5) për pozitën “*Inspektor Fitosanitar*”- **Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës**, në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit, ku afati për aplikim ka qenë i hapur nga data 31.10.2024 deri me datë 29.11.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesit, mirëpo ankuesit E.H. përmes Njoftimit të datës 12.12.2024 Sektori i Personelit i AUV-së i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, respektivisht kualifikimin përkatës të fushës së arsimit.

Tutje, sipas listës së verifikimit të kandidatëve, arrihet në konstatimin se tridhjetë e tetë (38) kandidatë e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa sipas Njoftimit të datës 27.12.2024 të renditjes përfundimtare të kandidatëve, konstatohet se kandidatë të suksesshëm rezulton të jenë gjashtë (6) kandidatë, respektivisht kandidati H.A me gjithsejtë 89.4 pikë, kandidati D.K me gjithsejtë 85.6 pikë, kandidati I.Sh me gjithsejtë 83.6 pikë, kandidati A.L me gjithsejtë 82.8 pikë, kandidati R.Xh me gjithsejtë 78.8 pikë dhe kandidati përkatësisht ankuesi N.D. me gjithsejtë 74.8 pikë i cili në këtë listë renditet i gjashti me radhe.

Ankuesit E.H. dhe N.D., në ankesat e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshtojnë procedurën e rekrutimit për pozitën „Inspektor Fitoasnitari”, të shpallur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, duke kërkuar nga Këshilli që të aprovohen ankesa e tyre dhe të anulohet konkursi në tërësi.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesve të parashtruara si në ankesë dhe duke u bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati M.M, si kandidatë pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015652, më datë 29.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.238/2025, të datës 13.03.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015652, për pesë (5) pozitë e punës *Inspektor Fitosanitar*, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, respektivisht Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesve të parashtruara si në ankesa, thekson faktin se objekti i ankesave është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.238/2025, dhe për pasojë është **anuluar** konkursi i lartpërmendur, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.238/2025, të datës 13.03.2025, është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015625, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.130/2025 të datës 17.01.2025 dhe ankesës me numër A.nr.234/2025 të datës 29.01.2025 të cilat në bazë të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, janë bashkuar në ankesën me numër A.nr.234/2025 të datës 29.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.234/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit; N.D. te cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e Avokateve “SCKR partneres”
- Ankuesit; E.H.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.